

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarit SH G nga fshati Komuna e Prizrenit, për shkak të veprave penale: kanosje nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPK dhe asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, nën numrin PP/II.nr.3650/2015 të datës 23.12.2015, në shqyrtimin fillestar në prezencën e prokurorit të shtetit Sahide Sefa, të akuzuarit dhe të dëmtuarave H G e M G që të dyja nga fshati Komuna e Prizrenit, me datë 12.04.2016 në prezencën e palëve publikisht morri dhe shpalli këtë:

AKTGJYKIM

Ndaj të akuzuarit

SH G nga i ati Isla dhe e ëma Hate e lindur Sinanaj, i lindur me datë 18.06.1973 në fshatin Komuna e Prizrenit ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, bujk, i martuar baba i katër fëmijëve, me numër personal , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

Konform nenit 363 par.1 nën par.1.1 të KPPK.

REFUZOHET AKUZA

1. Me datë 01.12.2015 rreth orës 16:30 minuta, në shtëpinë e tyre familjare në fshatin Komuna e Prizrenit, seriozisht e kanos të dëmtuarat H G dhe M G, me fjalë dhe gjeste se do të privoj nga jeta, ku fillimisht nga e dëmtuara M G i kërkon 200 € për rregullimin e automjetit, të cilat e dëmtuara nuk ka pasur për t'ia dhënë, i revoltuar me këtë akuzuari merr një dru me të cilin tenton ta godas të dëmtuarën, me ç'rast ndërhyjnë nëna e tyre e dëmtuara H G dhe bashkëshortja e akuzuarit, ashtu që derisa e dëmtuara M G ishte mbyllur në dhomë i kanoset me fjalë "ku keni me shku ju të dyja, kam me ju pre, kam me ju vra, kam me ju shky" kështu që tek të dëmtuarat ka shkaktuar frikë ankth dhe pasiguri.

Kësodore kishte për të kryer veprën penale të kanosjes nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPK.

Për shkak se prokurori shtetit në Prizren – në shqyrtimin fillestar në mbështetje të nenit 363 par.1 nën par.1.1 të KPPK, është tërhequr nga aktakuza.

PËR SHKAK

2. Me datë 01.12.2015 rreth orës 16:30 minuta, në shtëpinë e tyre familjare në fshatin Komuna e Prizrenit, i akuzuari e përdor forcën dëmton dhe e bënë të papërdorshme pasurinë e dëmtuarës M G duke e goditur me mjet të fortë xhamin – parafagun e automjetit të

arkës "VW Golf IV" me targa të regjistrimit të cilin ia dëmton në tërësi duke e
re mjetin e papërdorshëm.

**Këso dore ka kryer veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333
par.1 të KPK.**

Gjykata në kuptim të dispozitave të nenit 7, 85, 86, 73, nenit 333 par.1 të KPK i shqipton:

VËREJTJE GJYQSORE

I akuzuari Sh. G. pasi që ka kryer veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i
pasurisë nga neni 333 par.1 të KPK, vepër penale e cila është e rrezikshme dhe e dëmshme, i
bëjti nëse sërish kryen vepra të tilla do të dënohet me dënim më të rëndë.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së
gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15
ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë
nën numrin PP/II.nr.3650/2015 të datës 23.12.2015 kundër të akuzuarit Sh. G. nga
fshati Komuna e Prizrenit, për shkak të veprave penale kanosje nga neni 185 par.2 lidhur
me par.1 të KPK dhe asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPK.

Në shqyrtimin kryesor të datës 12.04.2016 pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të
shtetit e dëmtuara H. G. deklaroi se vullnetarisht tërhiqet nga propozimi për ndjekje
penale kundër të akuzuarit Sh. G. dhe atë për shkak të veprës penale kanosje nga neni
185 par.2 lidhur me par.1 të KPK. E dëmtuara tërheqjen e propozimit e arsyeton me faktin se të
akuzuarin e ka djalë, raportet e tyre janë të mira dhe jetojnë bashkë. Asnjëherë nuk kanë pasur
probleme të kësaj natyre, andaj tërheq kërkesën për ndjekje penale të akuzuarit, për veprën penale
objekt i akuzës e kryer në dëm të saj.

E dëmtuara M. G. deklaroi se ditën kritike për shkak të mosmarrëveshjes që
kishte me të akuzuarin Sh. G. ka ardhur gjer tek konflikti ku i akuzuari është kanosur
dhe për këtë ka qenë e shqetësuar. Përndryshe të akuzuarin e ka vëlla, raportet e tyre janë
rregulluar, nuk kanë probleme dhe jetojnë bashkë. Prandaj si palë e dëmtuar tërhiqet nga
propozimi për ndjekjen e mëturjes penale ndaj të akuzuarit, për shkak të veprës penale
kanosje nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPK e kryer në dëm të saj.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin kryesor, duke u bazuar në deklaratat e dëmtuarve H.
G. dhe M. G. dhënë në shqyrtimin kryesor, të cilat vullnetarisht janë tërhequr nga
propozimi për ndjekjen penale në dëm të tyre, andaj edhe përfaqësuesi i akuzës, është tërhequr

nga akuza për veprën penale si nën **I.** të dispozitivit të aktakuzës, pasi që vepra penale e kanosjes nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPK, fillon sipas propozimit të dëmtuarit.

Meqenëse prokurori shtetit gjatë shqyrtimit kryesor është tërhequr nga aktakuza kundër të akuzuarit, gjykata konform nenit 363 par.1 nën par.1.1 të KPPK, ka vendosur si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit. I akuzuari nuk e kundërshtoj provat dhe e pranoj fajësinë për veprën penale nën **II.** të dispozitivit të aktakuzës, për veprën penale dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPK.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike në datë 01.12.2015 rreth orës 16:30 minuta, në shtëpinë e tyre familjare e cila gjendet në fshatin Komuna e Prizrenit, për shkak të mosmarrëveshjes paraprake me motrën – të dëmtuarën, i akuzuari S. G., e përdor forcën dëmton dhe e bënë të përdorshme pasurinë e dëmtuarës M. G. duke e goditur me mjet të fortë parafagun e automjetit të markës “VW Golf IV” me targa të regjistrimit të cilin ia dëmton në tërësi duke e bërë mjetin e përdorshëm. Kështu të dëmtuarës i shkakton dëm të konsiderueshëm material.

E dëmtuara M. G., pasi që nga ana e gjykatës udhëzohet për të drejtat që i takojnë sipas ligjit, në seancën fillestare ka deklaruar se nuk parashtron kërkesë pasurore juridike ndaj të akuzuarit.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar nga pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e akuzuarit për veprimet e tij të përshkruara si nën **II.** të dispozitivit të aktakuzës. Gjykata nuk ka administruar provat, pasi që nuk ka ekzistuar ndonjë provë e papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale me të cilën ngarkohet dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht. Vlen të theksohet se pranimi i fajit është mbështetur në fakte që përmban aktakuza, me ç'rast i akuzuari prej fillimit të procedurës ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat asnjëherë nuk i ka kundërshtuar. Po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 246 të KPPK dhe në veprimet e tij formohen të gjitha elementet e qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese morri parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunim me organet e drejtësisë, sjellja korrekte gjatë zhvillimit të procedurës, është kryefamiljar dhe mbajtës i vetëm i familjes, me të dëmtuarën ka rregulluar raportet dhe tani nuk kanë probleme, pendimi për kryerjen e veprës penale, gjer më tani nuk ka kryer vepër penale, andaj gjykata duke pasur parasysh të gjitha rrethanat lidhur me kryesin dhe

23

Prën e kryer i shqiptoi vërejtje gjyqësore, sepse konsideron se me qortim do të arrihet qëllimi i qortimit, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me qortim do të arrihet qëllimi i qortimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurta më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi konform nenit 498 të KLPK.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr.2193/2015 të datës 12.04.2016

Procesmbajtësja
Ervete Përdibuka



Gjyqtarja
Teuta Krusha



DHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes së njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.